

Më datën 9 Gusht 2014, u zhvillua Konferenca Zgjedhore e BSPSH-së, Rajoni Shkodër, në zbatim të programit të fushatës zgjedhore, në kuadrin e Kongresit të VI të BSPSH-së, me pjesëmarrjen e 100 delegatëve që përfaqësojnë 3159 anëtarë të seksioneve profesionale të këtij rajoni. Në konferencë mori pjesë Presidenti i BSPSH-së, zoti Gëzim Kalaja si dhe monitoruesi i konferencave zgjedhore të rajoneve dhe rretheve, Sekretari Organizativ i BSPSH-së, zoti Koço Jani. Raportin në emër të Këshillit Sindikal të Rajonit Shkodër, mbi aktivitetin 5 vjeçar të organizatës sindikale të rajonit, e mbajti zoti Albert Tuka, i cili raportoi mbi aktivitetin sindikalist të Këshillit Sindikal të rajonit dhe seksioneve profesionale të anëtarësisë sindikale. Në raport u trajtuan problemet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave social- ekonomike të punonjësve, e konkretizuar kjo me nënshkrimin e kontratave kolektive, me punëdhënësit publik dhe sipërmarrësit privatë, me organizimin e protestave për punonjësit e transportit të autoveturave 8+1, ndaj pezullimit të veprimtarisë së tyre, me automjet jasht qarkut si dhe punonjësve të sindikatës së tregëtarëve të vegjël. Rreth raportit të Këshillit Sindikal pati pyetje dhe diskutime nga delegatët, të cilët në përgjithësi ngritën çështje të organizimit më të mirë të punës së strukturave drejtuese të rrethit e të federatave sidomos në drejtim të mbrojtjes të punonjësve nga largimet nga puna dhe ato të përmirësimit të kushteve të punës. Konferencën e përshëndeti edhe Presidenti i BSPSH-së, zoti Gëzim Kalaja, ku midis të tjerave vlerësoi punën e mirë të Këshillit Sindikal të Rrethit dhe të këshillave sindikale të seksioneve profesionale. Presidenti i BSPSH-së, në fjalën e tij, theksoi përmirësimin e mëtejshëm të punës koordinuese midis strukturave drejtuese të rrethit e federatave, për të realizuar më mirë objektivin kryesor të sindikatës mbrojtjen e të drejtave të punonjësve, sidomos në situatën aktuale të masave shtrënguese që ka marrë dhe po merr qeveria me rritjen e çmimeve dhe vendosjen e taksave të reja sipas programit qeveritar të miratuar edhe nga FMN. Gjithashtu zoti Kalaja i njohu pjesëmarrësit e Konferencës me politikat e qeverisë për reformën në fushën e pensioneve, si dhe me qëndrimet e BSPSH-së ndaj skemës së sigurimeve shoqërore si ato të mosngritjes së moshës së daljes në pension, për gratë mbi 63 vjeç dhe për burrat mbi 65 vjeç si dhe për ndryshimin e formulës së llogaritjes së pensionit jo mbi bazën e pensionit social por mbi bazën e pagës minimale gjë që do të influencojë në ruajtjen e pensioneve të ulëta për ata pensionistë që do të dalin në pension pas 1 janarit 2015. Në përfundim, Konferenca zgjedhore e Rajonit Shkodër, vazhdoi me procedurat e votimit për drejtuesin e ri të Këshillit Sindikal si dhe të deklarimit të votave me mandate përfaqësimi për kandidatët për President të BSPSH-së. Komisioni i votimit, mbas verifikimit të votave shpalli drejtuesin e Këshillit Sindikal të Rajonit Shkodër, zotin Albert Tuka.





